

**STATUTI SHOQËRISË
SHOQERISE TREGETARE “ ISTE ” SHPK
(ORTAK I VETËM)**

FORMIMI

Neni 1

Formohet shoqëria private me emërtimin “ ISTE ”, me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar nga ortaku i vetëm Z. ILIR BARDHI, i biri i Vasilit , i datëlindjes 05 tetor 1974, lindur ne Zavaline dhe banues ne Kuqan , “ me dokument identifikimi Certifikate personale me fotografi nr. 4/82, leshuar me date 12.07.2006.

SELIA E SHOQËRISË

Neni 2

Selia e shoqërisë është në Kuqan , Prefektura Elbasan, Shoqëria mund të hap edhe vëndqëndrime të tjera të dyta, filjale, agjensi në të gjithë territorin e vëndit.

KOHË ZGJATJA

Neni 3

Kohë zgjatja e veprimitarise së shoqërisë është mbi dhjetë vjet dhe mund të shpërbëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo shkaku.

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Neni 4

Objekti i veprimitarise është:

1.Shfrytezim pylli, pillezime , permiresime dhe sistemime pylli, prodhim e tregetim lende drusore dhe zjarri, prodhim e tregetim mobilje me shumice e pakice , import- eksport tregetim I artikujve ushqimor e inndustrial me shumice e pakice import- eksport I tyre , prodhim dhe tregetim I artikujve te ndryshem bujqesore e blegtore , fruta , perime me shumice e pakice import eksport, prodhime dhe tregetimi buke me shumice e pakice.

Neni 5

Shoqëria mund të ndryshojë emrin, selinë, si dhe objektin e veprimitarise së sajë, pas vendimit që do të marr pronari i saj, ortak i vetëm.

KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 6

Kapitali i shoqërisë është 100.000 (Njeqint mijë) lek dhe i formuar tërësisht nga ortaku i vetëm.

Neni 7

Kapitali i shoqërisë mund të shtohet ose të paksohet, pas vendimit që do të marre ortaku i vetëm.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Neni 8

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plot të normave që përbanë ky statut dhe ato të legjislacionit shqiptar në fuqi.

Shoqëria fiton zotësinë për të vepruar me regjistrimin e sajë si person juridik përpara gjykatës së rrethit Tiranë, ndërsa e ushtron veprimtarinë e saja me regjistrimin në zyrën e Tatimeve.

Neni 9

Shoqëria ka vulen e saj me përbajtjen: " Shoqëria private " ISTE " SHPK.

Neni 10

Shoqëria vepron me regjistrimin e pronës private dhe merr përsipër vet të drejtat dhe detyrimet.

Ajo përgjigjet vet për detyrimet e saja kontraktuale dhe jashtë kontraktuale, brënda kapitalit të sajë. Ortaku i vetëm mbart rriskun e veprimitarisë së Shoqërisë, në nivelin e shumës së mjeteve të investuara në shoqëri.

Neni 11

Shoqëria është pronë e themeluesit të saj, ajo merr vendime në zbatim të ligjeve dhe sipas këtij statuti, të cilat janë të detyrueshme për të gjithë punonjësit e shoqërisë.

Neni 12

Ortaku i vetëm, sipas nevojave që paraqiten, për zhvillimin e veprimitarisë, te shoqerise emeron administratore si dhe punonjës të veprimitarive të ndryshme ekonomike duke i punësuar, në përshtatje me nenin katër të këtij statuti.

Neni 13

Ortaku i vetëm i shoqërisë është ILIR BARDHI , dhe administrator po ILIR BARDHI , është i veshur me të gjitha fuqitë për drejtimin e zakonshëm të shoqërisë, pa asnjë lloj kufizimi, për interesat e ligjëshme të shoqërisë. Ai ka mundësi të kryejë të gjitha aktet që konsideron të nevojshëm për arritjen e qëllimit të shoqërisë, ai ka të drejtë të blejë e të mbajë pasuri, të lidhet me shoqëri të tjera të vëndit ose të huaja, të kryejë çdo lloji veprimi pranë të gjitha zyrave private apo shtetërore, që kanë të bëjnë me garancitë dhe ipotekën, të kryejë veprime financiare dhe depozitimi pranë institucioneve bankare dhe financiare, si dhe kreditime, pagesa dhe arkëtime. Në këto raste punonjësi i ngarkuar ka për detyrë të njoftojë dhe t'i jap llogari ortakut të vetëm.

Neni 14

Përfaqësimi i shoqërisë i përket ortakut të vetëm dhe punonjësit të ngarkuar. Ai ka të drejtën e përfaqësimit në organet gjyqësore dhe administrative, të caktøjë avokat për çdo problem dhe të revokojë atë në çdo kohë.

Neni 15

Veprimet ekonomike dhe financiare të shoqërisë mbyllen më 31 dhjetor të çdo viti.

Në fund të çdo periudhe tre muajore, administratori nxjerr bilançin kontabël të shoqërisë me llogarinë "Fitim – Humbje", mbështetur në ligjet dhe rregullat e mbajtjes së kontabilitetit nga subjektet private, përcaktuar nga organet kompetente të sistemit fiskal. Bilanç kontabël miratohet nga ortaku i vetëm, i cili vendos për krijimin e fondevë të ndryshme të nevojëshme për zhvillimin dhe garantimin e veprimitarës së shoqërisë, fondin e akumulimit, fondin rezerv, etj.

Neni 16

Të ardhurat neto, pas veçimit të fondevë ligjore të përmëndura më sipër dhe pas shlyerjes së detyrimeve fiskale nga fitimi, i mbresin për përdorim ortakut te vetem.

SHPËRNDARJA E SHOQËRISË

Neni 17

Shpërndarja e shoqërisë mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo lloji shkaku, si humbja e kapitalit, pamundësia për veprimitari etj. Në këto raste ortaku i vetëm vendos mbi mënyrën e likuidimit dhe cakton një ose disa likuidatorë. Këta bëjnë kujdes që shoqëria të likuidojë më parë detyrimet që ajo ju ka personave të tretë fizik dhe juridik.

DISPOZITA TË PËRGJITHËSHME


Neni 18

Për sa nuk është shkruar në këtë statut, i referohet plotësimeve nga ortaku i vetëm dhe ligjeve përkatëse shqipëtare.

Neni 19

Ky statut përpilohet në katër origjinalë, për t'ju shpërndar organeve kompetente, ndërsa nga këto, një mbetet si pjesë përbërëse e dokumentacionit të themelimit të shoqësisë.

ORTAKU I VETËM
(ILIR BARDHI)



Ilir Bardhi

AKTI I THEMELIMIT TE SHOQERISE
“ISTE “, SH.P.K.

Sot, me daten 14.07.2006, une i quajturi ILIR BARDHI , i biri i Vasilit dhe i Marise, i datelindjes 05. Tetor 1974, lindur ne Zavaline , dhe banues ne Kuqan, me dokument identifikimit Certifikate personale me Fotografi nr. 4/82, leshuar me date 12.07.2006.

NENI 1

Te themeloje shoqerine “ Iste “ me pergjegjesi te kufizuar, SH.P.K. e cila do te veproje ne perputhje me legjislacionin ne fuqi , dispozitat e kesaj kontrate dhe statutin e shoqerise.
Kjo shoqeri emertohet “ Iste “ SH.P.K.

NENI 2

Shoqeria qe themelohet do te kete seline e saj ne Fshatin Kuqan, Prefektura Elbasan, me te drejte te hapi dege , filiale, zyra , ne te gjithe teritorin e vendit dhe jashte saj , duke ushtruar veprimtarine “ Shfrytezim pylli, permiresime dhe sisteme pylli, prodhim e tregetim lende drusore dhe zjarri, prodhim e tregetim mobilje me shumice e pakice, import –eksport , tregetim i artikujve ushqimor e industrial me shumice e pakice, import – eksport i tyre , prodhim dhe tregetim i artikujve te ndryshem bujqesor e blegtoral, fruta , perime me shumice e pakice, import- eksport, prodhim dhe tregetim buke me shumice e pakice, per nje perjudhe kohe mbi 10 vjet.

NENI 3

Shoqeria do te kete per objekt te veprimtarise se saj :
Shfrytezim pylli, permiresime dhe sisteme pylli, prodhim e tregetim lende drusore dhe zjarri prodhim e tregetim mobilje me shumice e pakice, import- eksport, tregetim i artikujve ushqimor e industrial me shumice e pakice, import- eksport i tyre, prodhim dhe tregetim bujqesor blegtoriale , fruta, perime, me shumice e pakice, prodhim dhe tregetim buke , me shumice e pakice .

NENI 4

Shoqeria mund te ndryshoje emertimin , seline , objektin e veprimtarise , kohezgjatjen dhe gjithcka tjeter sipas vendimit qe do te marre ortaku i vetem i. saj .

NENI 5

Kapitali themeltar i shoqerise do te jete ne shumen 100.000 leke shqiptare .

NENI 6

Kapital i shoqerise mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimit qe do te marre ortaku i veten. Zmadhimi i kapitalit mund te realizohet si nepermjet kontributeve ne para ashtu edhe nepermjet atyre ne natyre . Zvogelimi i kapitalit do te kryhet kur kjo gje motivohet nga humbjet ose kur ortaku i vetem vendos te anulloje pjesen e kapitalit themeltar .

NENI 7

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te trasferueshme ne rruge trashegimie ose brenda familjes (ndermjet bashkeshorteve , paraardheseve dhe pas ardheseve) Ortaku

i vetem mund ti shes lirisht te treteve teresisht ose pjeserisht kuotat e kapitalit themeltar.

NENI 8

Shoqeria do te drejtoje nepermjet vendimeve qe do te marre ortaku i vetem ILIR BARDHI , administratore vetem ILIR BARDHI. Vendime te cilat do te evidentohen ne nje rregjister. Administrimi i shozerise do te kryhet nga administratori i saj ILIR BARDHI. Procedura emerimit , kohezgjatja e mandatit , shkarkimit kopetencat e administratorit etj . Percaktohen ne statutin e shozerise.

NENI 9

Shoqeria do ti realizoje transaksionet e saj financiare nepermjet llogarive rrjedhese qe duhet te hape ne Bankat shqiptare dhe te huaja . Per kapitalin themeltar te shozerise eshte hapur libri i llogarive dhe shoqeria ka dhe perdor dokumentacionin financiar ne perputhje me dispozitat ne fuqi per kontabilitetin .

NENI 10

Shoqeria e fillon veprimtarine e saj tregtare vetem pasi te kete siguruar miratimin e organeve kopetente sic parashikohet ne legjislacionin shqiptar ne fuqi .

NENI 11

Kjo kontrate u perpilua me vullnetin e lire e te plote te ortakut te vetem , ne kater kopje te njeta , ne gjuhen shqipe , me fuqi te barabarte ligjore , per tu depozituar ne organet gjyqesore e tatimore , si dhe ne dokumenta baze te shozerise.

PER SHOQERINE TREGTARE " ISTE ", SHPK

ILIR BARDHI

Ilir Bardhi

BB

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE ELBASAN
Nr. 2504 REP. 330 KOL.

V E R T E T I M

Sot, me date 14.07.2006, perpara meje noterit Selim Beqiraj, me seli prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Elbasan, u paraqit personalisht :

ILIR BARDHI, i biri i Vasilit i datelindjes 05 tetor 1974, lindur ne Zavaline dhe banues ne Kuqan, Prefektura Elbasan , dokument identifikimi Certifikate personale me fotografji nr. 4/82, leshuar me date 12.07.2006.

Madhere, me kombesi dhe shtetesi Shqiptare, i afte per te kryer veprime juridike dhe i njojur prej meje ne baze te dokumentave te identifikimit (certifikate personale me fotografji) qe me paraqiti, i cili me "deklaron se jame dakort me permbatjen e ketij akti "dhe e nenshkuani rregullisht, ne pranin time si noter.

U vertetua dhe nga une noteri Selim Beqiraj.

NOTE R
SELIM BEQIRAJ

Beqiraj